

## Bursa për Gazetari 2023

### *Udhëzuesi për aplikim*

#### Sfondi

Kosovo 2.0 u themelua si lloj i ri i platformës gazetareske për Kosovë, rajon dhe më gjerë — platformë, e cila refuzon që çështjet e rëndësishme t'i kthejë në kryetituj sensacional. Ne jemi të përkushtuar ndaj gazetarisë shpjeguese, kontekstuale, ku rrëfimtaria nuk ka të bëjë vetëm me dokumentimin e botës përreth nesh, por kontribuon në riimajinimin e kësaj bote.

E themeluar në vitin 2010 si platforma e parë e blogjeve në Kosovë, K2.0 u zgjerua dhe u konsolidua si një zë kritik dhe i besueshëm gazetaresk në vend e përtej. Përgjatë viteve, K2.0 ka botuar një varg revistash të shtypura, përpara se të kalonte në një model të revistës online. Vazhdimisht kemi organizuar një gamë të larmishme ngjarjesh publike dhe nismash për edukimin joformal, të cilat i shohim si thelbësore për misionin tonë më të gjerë gazetaresk.

Në fakt, teksa gazetaria jonë shpesh formësohet si një lloj historie ose bisede e shkruar, video-historie, foto-storie ose me zë, ajo gjithashtu mund t'i ngajë një ligjërata, bashkë bisedimi, mbledhjeje a diskutimi publik; një punëtori, masterklase ose programi për të rinjtë; një filmi a ekspozite arti; një fushate; apo të gjithave. Duam që t'i përkushtojmë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme ndërtimit të aftësive të tjerëve/ave (përfshirë gazetarët/et) që ta shohin politikën, demokracinë dhe gazetarinë me ndjenjën e agjencisë dhe përgjegjësisë qytetare.

Gjithçka që organizojmë në K2.0 e që s'janë vetëm prodhime gazetareske, janë pjesë e HUB 2.0, platformës sonë për angazhim qytetar dhe zhvillim të aftësive. Konkretisht, "Programi i bursave për gazetari" është platforma jonë për fuqizimin e gazetarëve/eve të rinj/reja dhe të sapo-diplomuarve — tashmë po e hapim edhe raundin e katërt vjetor.

Bursa për Gazetari 2023 është pjesë e projektit "Human Rightivism", i cili financohet nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë dhe zbatohet nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit përmes programit të tij "[Human Rightivism](#)".

#### Programi

Programi i bursave për gazetari për vitin 2023 do të fillojë në maj 2023 dhe do të përfundojë në dhjetor 2023. Gjithsej pesë (5) bursistë/e do të zgjidhen për t'u bërë pjesë e programit. Programi do t'u ofrojë pjesëmarrësve aftësitë dhe mjetet e nevojshme për t'i zhvilluar prodhimet e tyre gazetareske deri në fund të vitit.

## K2.0

Kjo do të bëhet duke ofruar (1) **trajnim**, (2) **mentorim** dhe (3) **mbështetje financiare** për gazetarët/et që janë në fillet e karrierës, duke iu ofruar atyre mundësinë për të prodhuar, nën mbikëqyrjen e redaktorëve me përvojë, histori të mëdha e të vlerësuara me çmime, që si pikëpamje kanë fushën e të drejtave të njeriut.

Në fillim të programit, do të organizohen dy javë trajnime intensive (gjithsej 10 ditë). Trajnimi do të ndahet në dy pjesë: pesë ditë ligjërata dhe pesë ditë ku do diskutohen aspektet praktike e teknike.

Gjatë pesë ditëve të para përqendrimi do të jetë në etikën gazetareske dhe mjetet gazetareske të nevojshme për të prodhuar produkte të pavarura dhe origjinale. Këtu përfshihen njohuritë teorike të nevojshme për të realizuar e prodhuar raportime cilësore për tema të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut, siç janë pakicat gjinore, seksuale dhe etnike, mjedisi, ballafaqimi me të kaluarën etj.

Pesë ditët tjera të trajnimit do të përqendrohen në aftësitë teknike lidhur me mediumet e ndryshme të gazetarisë multimediale, të tilla si metodologjia e hulumtimit dhe intervistat, shkrimi, redaktimi, prodhimi i videove dhe fotografive dhe të tjera.

Kjo fazë paraprake e ndërtimit të kapaciteteve do t'i pajis bursistët/et me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për t'i zhvilluar produktet e tyre dhe do të shoqërohet me mentorim nga afër. Në fakt, gjatë gjithë periudhës së programit të bursave, bursistët/et do të punojnë ngushtë me redaktorët/et e K2.0, të cilët/at do t'i shoqërojnë ata nga fillimi deri në fund të zhvillimit të storieve të tyre — duke ua mundësuar kështu transferimin e vazhdueshëm dhe të gjerë të aftësive në prodhimet gazetareske të cilësisë së lartë. Ndër të tjera, këtu përfshihen takime të rregullta mes bursistëve/eve dhe redaktorëve/eve përkatës/e, si dhe raportime periodike nga bursistët/et rreth përparimit të stories.

Si rezultat i programit, nga secili/a bursist/e i/e përzgjedhur pritet që ta prodhojë **një përmbajtje sipas seksionit tonë “n’thelb”**, në një nga formatet e mëposhtme:

- Në formë të shkruar (deri në 4,000 fjalë),
- Video (10 - 20 minuta),
- Ese fotografike (15-20 fotografi të shoqëruara me tekst),

Deri në fund të programit, përmbajtjet do të përkthehen/titrohen në gjuhën shqipe, angleze dhe B/C/S, si dhe do të botohen nga Kosovo 2.0.

## K2.0

Çdo bursistë/e do të:

1. përfitojë gjithsej **2,500 EUR** bruto për prodhimin e një artikulli në njërën nga formatet e përmendura më sipër;
2. do të jetë pjesë e programit të trajnimit, që organizohet në fillim të programit të bursave mbi prodhimin e historive, standardeve dhe etikën gazetareske, formatet multimediale, përmbajtjen vizuale dhe legjislacionin për të drejtat e njeriut në Kosovë;
3. do të punojë me përgjegjshmëri nën mbikëqyrjen e një redaktori/eje.

Bursistët/et duhet të jenë pjesë e të gjitha aspekteve të programit dhe duhet t'i përmbushin rezultatet e programit të bursave plotësisht dhe në kohë, siç përshkruhet në këtë dokument.

Moskryerja me sukses e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive që parashikohen në kuadër të Programit të Bursave për Gazetari 2023, rezulton në ndërprerjen e kontratës dhe humbjen e të gjitha privilegjeve që burojnë nga programi, përfshirë edhe ato të natyrës financiare.

### **Kërkesat për t'u kualifikuar dhe vlerësimi**

Për t'u kualifikuar në Programin e Bursave për Gazetari, aplikanti/ja duhet:

1. të jetë gazetar/e i/e ri/e, i/e pavarur ose i/e vetëpunësuar, i/e punësuar ose i/e papunë,
2. shtetas/e i/e Kosovës dhe me vendbanim në Kosovë,
3. i/e grupmoshës 18 deri në 35 vjeç,
4. të ketë të paktën dy vjet përvojë të dëshmuar në fushën e gazetarisë.

Bursistët/et e kaluar të K2.0 nuk kanë të drejtë aplikimi. Gratë dhe pjesëtarët e pakicave seksuale dhe etnike inkurajohen shumë të aplikojnë.

Aplikimet, ato që janë të plota dhe që dorëzohen me kohë, do të vlerësohen nga një juri që përbëhet nga tre persona, pjesë e ekipit të K2.0. Rezultati i përgjithshëm i secilit/es aplikant/e do të bazohet 40% në kualifikime dhe përvojë, ndërsa 60% në bazë të propozimit të temës që do ta trajtojë (Formulari i Aplikimit), që vlerësohet sipas treguesve të mëposhtëm: (1) rëndësisë, (2) originalitetit, (3) realizueshmërisë.

Aplikantët/et që do të përzgjidhen, do të identifikohen bazuar në mesataren aritmetike të pikëve të përgjithshme të caktuara nga secili anëtar/e i/e jurisë.

Në vlerësimin e tyre, juria do t'i kushtojë vëmendje llojllojshmërisë tematike të storieve që do të mbështeten dhe do të promovojë parimet e mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirjes.

## K2.0

Secili aplikant/e do të njoftohet për vlerësimin e aplikimit.

Përfitimi nga dhe pjesëmarrja në “Bursa për Gazetari 2023” vlen vetëm për vitin 2023. Kështu, nuk mund të shtyhet për vitet/raundet vijuese të programit të “Bursave për Gazetari”.

### Si të aplikoni?

Afati i fundit për të dorëzuar aplikimin tuaj është **23 prill 2023**.

Aplikimet e kompletuara duhet të dërgohen në formë elektronike (*word* ose *pdf*) në adresën: <info@ktwopointzero.com> me titullin “Aplikim për Bursën për Gazetari”. Është përgjegjësi vetëm e aplikuesit/es që të sigurohet që dorëzojë dokumente që janë të lexueshme dhe të qasshme, përndryshe mund të rrezikoni të përjashtoheni.

Një dosje e kompletuar e aplikimit përbëhet nga:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar siç duhet;
2. CV që vërteton dy vjet përvojë në gazetari;
3. Fotokopje e letërnjoftimit;
4. Letra e mbështetjes nga punëdhënësi/ja i aplikantit/es (vlen vetëm për të punësuarit/at);
5. Portfolio të punës së mëparshme.

Lidhur me pikën 4, aplikantët/et që për momentin janë në marrëdhënie pune duhet të jenë në gjendje t'i kushtojnë kohë programit, përfshirë trajnimin, takimeve me redaktorët/et dhe të ngjashme. Për këtë arsye, letra mbështetëse nga punëdhënësi/ja i aplikantit/es që mbështet shprehimisht pjesëmarrjen e tyre të plotë në Programin e Bursave duhet të përfshihet në dosjen e aplikimit.

Sa i përket pikës 5, një portfolio duhet të përfshijë një listë me të paktën dy shembuj të punës suaj të publikuar më parë, e shoqëruar me vegëzën [link] e atyre punëve. Është përgjegjësi vetëm e aplikuesit/es që të sigurohet që vegëzat e vendosura mund të hapen, përndryshe rrezikoni të përjashtoheni. Të paktën njëri nga shembujt e ofruar duhet të jetë i të njëjtit format të tregimit me formatin që aplikanti/ja ka zgjedhur në Formularin e Aplikimit. Në rast se aplikanti/ja dëshiron të japë shembuj të botimeve në formë të shtypur, që nuk janë të qasshme online, duhet të dërgojë një version të skanuar të punës..

Formulari i Aplikimit për Bursën për Gazetari 2023 është i qasshëm në uebfaqen e Kosovo 2.0. Aplikimet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

## K2.0

Aplikantët/et duhet t'i plotësojnë të gjitha pjesët e Formularit të Aplikimit sa më qartë që të jetë e mundur. Qëllimi i Formularit të Aplikimit është ta përshkruajë propozimin e aplikantit/es për tregimin që do të donin ta trajtonin gjatë Programit të Bursave.

Temat e propozimeve duhet të trajtojnë drejtpërdrejt problemet që **lidhen me të drejtat e njeriut**, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çështjet rreth barazisë gjinore, të drejtat LGBTIQ+, të drejtat e pakicave, të drejtat e rinisë, të drejtat mjedisore, të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat civile. Aplikantët/et duhet ta identifikojnë qartë një çështje ose temë specifike brenda fushës që kanë zgjedhur, kur ta prezantojnë idenë e tyre.

Propozimet e aplikantëve/eve duhet të dëshmojnë qasje origjinale ndaj aspekteve të hulumtimit dhe raportimit/prodhimit të temës. Propozimet mund të trajtojnë çështje kulturore, artistike ose çështjet e brendshme politike; megjithatë, ato duhet të karakterizohen nga një qasje dhe pikëpamje e qartë që është e ndjeshme ndaj të drejtave të njeriut.

Për fund, temat e propozimeve duhet të trajtojnë një çështje brenda kontekstit kosovar dhe prioritet do t'i jepet çështjeve që përqendrohen në nivelin lokal.

Të gjitha propozimet duhet të kenë kohëzgjatje prej **pesë muajsh** (për prodhimin e artikullit). Propozimet me kohëzgjatje më të shkurtër ose më të gjatë nuk do të merren parasysh.

Çdo pyetje në lidhje me hollësitë e Programit të Bursave ose rreth përgatitjes së dokumenteve për aplikim mund të dërgohet në: <info@ktwopointzero.com>, më së voni deri më **17 prill 2023**, me titullin "Pyetje rreth Bursaves për Gazetari".

Për arsye të paanësisë dhe transparencës, ju lutemi ta keni të qartë se nuk mund t'iu ofrojmë komente mbi përmbajtjen e propozimit tuaj përpara dorëzimit tuaj.

### Afatet kohore lidhur me Programin e Bursave për Gazetari 2023

27 mars 2023	Hapja e thirrjes
17 prill 2023	Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave/pyetjeve në K2.0
23 prill 2023	Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve

## K2.0

Maj 2023	Informacion për aplikantët/et rreth vlerësimit të aplikimeve të tyre
Maj 2023	Çmimet e Bursave
Maj - Qershor 2023	Trajnimi për bursistët/et e përzgjedhur/a
Qershor - Tetor 2023	Prodhimi i përmbajtjeve
Nëntor - Dhjetor 2023	Redaktimi dhe botimi i përmbajtjeve